



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.156, datë 27.06.2022

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Xhevahir Lita, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, transferuar me pëlqim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.
2. Zoti Xhevahir Lita do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, nga data 05.07.2022 – 04.10.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Xhevahir Lita do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Xhevahir Lita, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 27.06.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



ANËTAR
Bujar Sheshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurhan Seiti



ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Ludovik Dodaj

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani